



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



STRATEGJIA AFATMESME ZHVILLIMORE E PRISHTINËS

2008 – 2011

Vizioni për të ardhmen e Prishtinës:

Prishtina kryeqytet i Kosovës, me rol metropolian, e njohur për zhvillimin ekonomik, me urbanizëm bashkëkohor dhe shërbime efikase e cilësore, e integruar në zhvillimet rajonale e ndërkombëtare, qendër e jetës së begatshme kulturore, arsimore e sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale e financiare dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët.

Maj 2008, Prishtinë

Përmbajtja

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës	4
1. Përmbledhje ekzekutive	5
2. Korniza institucionale dhe qeverisja demokratike	6
3. Buxheti: burimet e të hyrave dhe shfrytëzimi i tyre	9
4. Bizneset dhe rrethina e biznesit	10
5. Shërbimet publike	11
5.1.Organizimi i shërbimeve publike	11
5.2.Investimet në infrastrukturë dhe në mirëmbajtje të rrugëve	12
5.3.Transporti, energjia dhe gjelbërimi	12
6. Zhvillimi dhe qëndrueshmëria urbane	14
6.1.Planet hapësinore të komunës	14
6.2.Çështje kyçe në planifikim hapësinor në komunën e Prishtinës	15
7. Zhvillimi rural	17
7.1.Popullsia dhe infrastruktura në zonat rurale	17
7.2.Resurset në zonat rurale	18
7.3.Aktivitetet ekonomike në zonat rurale	18
8. Arsimi, kultura, rinia dhe sporti	20
9. Shëndeti publik dhe mirëqenia sociale	22
10. Vlerësimi i aftësive konkurruese të Komunës së Prishtinës (SWOT analiza)	24
11. Vizioni	25
12. Synimet dhe objektivat për zhvillim të qëndrueshëm	25
Synimi I. Zhvillimi i bizneseve në Komunën e Prishtinës	25
Synimi II. Zhvillimi i qëndrueshëm rural	25
Synimi III. Zhvillimi i qëndrueshëm hapësinor dhe urban	25
Synimi IV. Ofrimi i shërbimeve publike cilësore	26
Synimi V. Zhvillimi i infrastrukturës dhe transport publik efikas	26
Synimi VI. Ofrimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës	26
Synimi VII: Promovimi i kulturës dhe jetës sportive për të rinjtë	26
Synimi VIII. Zhvillimi dhe modernizimi i administratës komunale	26
Synimi IX. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore dhe mirëqenies sociale	27
13. Projektet për arritjen e synimeve dhe objektivave	28
14. Shtojca II: Ekipi i strategjisë	38
15. Shtojca I: Harta e Komunës së Prishtinës	40

Shkurtesat

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
b.	Banorë
DPUN	Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari
FMN	Fondit Monetar Ndërkombëtar
ha	Hektare
IZHNJ	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
KEK	Korporata Elektro Energjetike e Kosovës
KK	Kuvendi i Komunës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PSZHUP	Plani Strategjik i Zhvillimit Urban të Prishtinës
PUN	Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
UNDP	United Nations Development Program
UNMIK	United Nations Mission Interim Kosovo

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës

Të dashur prishtinas,

Ne kemi filluar një jetë të re në Kosovën e re. Pas datës 17 shkurt 2008, kemi hyrë në fazën e realizimit të synimeve tona për një Kosovë të zhvilluar dhe të qëndrueshme ekonomikisht dhe politikisht. Prishtina me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është përcaktuar për Kryeqytet të Republikës së Kosovës.

Me këtë dokument strategjik ne po sigurojmë mekanizma që ta bëjmë realitet vizionin tonë, që ***Kryeqyteti i Kosovës, me rol metropolian, të jetë i njohur për zhvillimet ekonomike, të ketë urbanizëm bashkëkohorë dhe shërbime efikase dhe cilësore, i integruar në zhvillimet rajonale e ndërkombëtare, qendër e jetës së begatshme kulturore, arsimore e sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale dhe financiare, me jetë të rehatshme dhe cilësore për të gjithë qytetarët.***

Më këtë strategji zhvillimore, e cila mbulon periudhën kohore 2008-2011, ne fuqizojmë përfshirjen e komunitetit dhe të palëve të tjera me interes për të arritur progresin dhe kohezionin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës së Prishtinës përmes shfrytëzimit më të mirë dhe të balancuar të ambientit dhe të të gjitha resurseve tjera.

Objektivat tona në këtë strategji orientohen në realizimin e qëllimeve esenciale në interes zhvillimor të mbi gjysmë milioni qytetarëve. Duke ditur rolin e Kryeqytetit, ne po ashtu kemi për qëllim që të ofrojmë shërbime edhe për qytetarët tjerë të Kosovës dhe të banorëve jo të përhershëm të Prishtinës, si dhe të prezencës ndërkombëtare që, së bashku me komunitetin lokal, po luan rol të rëndësishëm në jetën publike, kulturore dhe ekonomike në Kryeqytetin tonë.

Ky dokument strategjik i zhvillimit të Komunës së Prishtinës është balancues dhe ndërton baza të mira për zhvillim të qëndrueshëm. Përveç objektivit parësor, që është zhvillimi ekonomik i Prishtinës, ka arritur që të ndërtojë baraspeshën zhvillimore në aspektin hapësinor, të zhvillimit social, arsimin, kulturës, infrastrukturës fizike dhe zhvillimit rural.

Prandaj, në cilësinë e Kryetarit të Komunës, unë ju ftoj që së bashku këtë dokument ta shndërrojmë në bazën strategjike zhvillimore, e cila do ta përcaktojë cilësinë e jetës sonë dhe të brezave që vijnë dhe qëndrueshmërinë tonë zhvillimore.

I juaji Kryetari,

Prof. dr. Isa Mustafa

1. Përmbledhje ekzekutive

Prishtina përveç se është qendër administrative dhe kulturore e vendit, është qyteti ku janë të koncentruara rreth gjysma e aktiviteteve ekonomike në nivel nacional. Si rezultat i zhvillimeve pas vitit 1999, Prishtina është ballafaquar me një rritje drastike të numrit të banorëve, duke shumëfishuar kështu problemet sociale, të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Periudha e pasluftës ka qenë një periudhë e definimit të zhvillimit institucional dhe ekonomik të Prishtinës. Me ndryshimin e sistemit elektoral për zgjedhjet e vitit 2007, Kryetari i Komunës zgjidhet me votat e qytetarëve dhe gjithashtu ka marrë kompetenca ekzekutive. Pas këtyre zgjedhjeve, Komuna e Prishtinës ka ndryshuar numrin e drejtorive për t'iu përgjigjur më mirë situatës së krijuar. Ligji për Komunën e Prishtinës, i cili pritet të miratohet në Kuvendin e Kosovës, do të sigurojë që për shkak të specifikave si kryeqytet Prishtina të ketë status të veçantë krahasuar me komunat tjera në Kosovë.

Me një buxhet prej 30.2 milion € (sa ka qenë në vitin 2007) është shumë e vështirë të mbulohen nevojat e një kryeqyteti në rritje. Rreth 62% e të hyrave sigurohen nga granti qeveritar dhe pjesa tjetër nga të hyrat vetanake. Të hyrat nga lejet e ndërtimit dhe nga tatimi në pronë, janë dy burimet kryesore të të hyrave vetanake. Me mbi 13 mijë biznese që operojnë në Komunën e Prishtinës, ekziston një potencial i madh i diversifikimit dhe rritjes së të hyrave komunale. Për shkak të numrit të madh të nxënësve prej mbi 50 mijë, pjesa më e madhe e buxhetit shpenzohet për arsim (në vitin 2007, 42% e buxhetit të komunës është shpenzuar për arsim).

Problem në vete paraqet ofrimi i shërbimeve publike cilësore për numrin në rritje të popullatës. Megjithëse janë bërë investime të konsiderueshme, situata është ende e pakënaqshme. Ka ende nevojë për shumë meremetime të rrugëve dhe ndërtim të rrugëve të reja, ndërtim dhe modernizim i rrjetit të kanalizimit, rritje e konsiderueshme e kapacitetit të furnizimit me ujë për qytetarët etj. Transporti publik është stabilizuar dukshëm, por ende ka nevojë për rritje të efikasitetit të funksionimit të tij. Orientimet e Komunës së Prishtinës janë që të sigurohet transport publik integral, që merr në konsiderim të gjitha format e transportit publik për të rritur efikasitetin dhe mënjeluar ngarkesën e vetëm një forme të transportit publik. Për shumicën e lagjeve janë përgatitur planet rregulluese, por zbatimi i plotë i tyre mbetet një sfidë për vitet e ardhshme, sidomos kur merren në konsideratë imigrimi i madh në qytet dhe rritja rapide e ndërtimeve për numrin në rritje të popullatës.

Megjithëse popullsia e Komunës së Prishtinës që jeton në zonat rurale është dukshëm më e vogël se në komuna tjera, ende mungon infrastruktura për jetë cilësore dhe për zhvillim të aktiviteteve ekonomike në këto zona. Edhe pse ka kapacitete për zhvillimin e shumë aktiviteteve, prodhimtaria bujqësore është në nivel jo të kënaqshëm,

Për të përballuar më me sukses sfidat për zhvillimin e komunës dhe për të krijuar një ambient më miqësor e më atraktiv për zhvillimin e biznesit dhe ngritjen e cilësisë së jetesës për banorët e saj, Komuna e Prishtinës ka përgatitur këtë dokument: ***“Strategjia zhvillimore afatmesme e Prishtinës 2008-2011”***. ***Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është që, pas identifikimit të gjendjes, përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve për Komunën e Prishtinës, të propozojë vizionin dhe të identifikojë synimet, objektivat dhe projektet konkrete që do të promovojnë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe jetë më të mirë për qytetarët e Komunës së Prishtinës.***

Pas shumë debateve, analizave dhe konsultimeve, Komuna e Prishtinës ka përvetësuar këtë vizion për zhvillimin e saj të qëndrueshëm dhe të balancuar ekonomik dhe shoqëror: ***“Prishtina kryeqytet i Kosovës, me rol metropolian, e njohur për zhvillimin ekonomik, me urbanizëm bashkëkohor dhe shërbime efikase e cilësore, e integruar në zhvillimet rajonale e***

ndërkombëtarë, qendër e jetës së begatshme kulturore, arsimore e sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale e financiare dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët.” Bazuar në këtë vizion dhe në problemet dhe mundësitë që ka Komuna e Prishtinës, ekipi i strategjisë ka identifikuar 9 synime, të cilat përmbajnë në vete 40 objektiva strategjike. Këto synime dhe objektiva kontribuojnë drejtpërdrejt në vizionin i cili ka një koncensus të gjerë. Synimet janë:

- Synimi I. Zhvillimi i bizneseve në Komunën e Prishtinës;
- Synimi II. Zhvillimi i qëndrueshëm rural;
- Synimi III. Zhvillimi i qëndrueshëm hapësinor dhe urban;
- Synimi IV. Ofrimin i shërbimeve publike cilësore;
- Synimi V. Zhvillimi i infrastrukturës dhe transportit publik efikas;
- Synimi VI. Ofrimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës;
- Synimi VII. Promovimi i kulturës dhe jetës sportive për të rinjtë;
- Synimi VIII. Zhvillimi dhe modernizimi i administratës komunale;
- Synimi IX. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore dhe mirëqenies sociale.

Janë identifikuar 232 projekte specifike, që sigurojnë arritjen e synimeve dhe objektivave me një kosto totale prej 429.4 milion € (Kapitulli 13). Megjithatë, kjo listë e projekteve nuk është përfundimtare, pasi që asaj mund t’i shtohen edhe projekte të tjera që mund të identifikohen në vazhdimësi. Për secilin projekt janë identifikuar partnerët implementues të mundshëm dhe afati i realizimit nga momenti i fillimit të projektit. Ekipi i strategjisë po ashtu ka identifikuar 29 projekte që potencialisht mund të realizohen me koncesion ose përmes partneritetit publik privat. Kostoja e të cilave sillet rreth 242.2 milion € (kjo shumë përfshihet brenda kostos së përgjithshme të strategjisë)

Procesi i hartimit të strategjisë ka qenë një proces gjithëpërfshirës me përfaqësues të të gjitha palëve të interesit, me vëmendje specifike në komunitetin e biznesit, shoqërinë civile, komunitetet, grupet sociale etj. Të gjitha aktivitetet për përgatitjen e kësaj strategjie janë koordinuar nga “Këshilli Drejtues i Strategjisë”, ku kanë marrë pjesë udhëheqësit më të lartë të komunës dhe drejtorët e departamenteve, përfaqësuesit e biznesit dhe të shoqërisë civile (shih Shtojcën II). Gjatë procesit të hartimit të strategjisë janë themeluar 6 grupe punuese me nga 5 anëtarë. Në secilin grup, së paku 3 anëtarë kanë qenë nga drejtoria përkatëse në komunë dhe 2 nga komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile. Instituti “Riinvest” në këtë proces ka mbështetur grupet punuese përmes ofrimit të ekspertizës së tij në hartimin e strategjisë dhe zhvillimit lokal, si dhe ka ofruar trajnimin e zyrtarëve komunalë në hartimin dhe zbatimin e projekteve. Për këtë qëllim, Instituti “Riinvest” ka angazhuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe ka organizuar 4 punëtori.

2. Korniza institucionale dhe qeverisja demokratike

Qyteti i Prishtinës si kryeqytet i shtetit, ka pësuar rritje shumë të madhe të popullsisë nga rreth 200 mijë banorë sa kishte në vitet e 1990-ta në mbi 450 000 banorë¹. Po ashtu, Prishtinës i është rritur edhe rëndësia strategjike në fushën ekonomike-administrative. Periudha e pasluftës (1999) ka qenë një periudhë e definimit të zhvillimit institucional dhe ekonomik të qytetit. Në aspektin organizativ dhe funksional, Komuna e Prishtinës përbëhet prej 33 bashkësive lokale. Prej tyre, 15 e përbëjnë qytetin e Prishtinës dhe 18 iu takojnë 48 fshatrave sa ka kjo komunë. Me zgjedhjet e para politike të mbajtura në vitin 2000 bëhet konstituimi i institucioneve demokratike dhe përfaqësimi i interesit të qytetarëve në sistem politik shumëpartiak. Ndërsa me zgjedhjet lokale të fundvitit 2007 është bërë edhe një hap tjetër progresiv në drejtim të ndërtimit të institucioneve demokratike dhe funksionale.

¹ Vlerësimi i numrit të banorëve bëhet sipas përlloraritjeve sepse mungojnë statistika të sakta si rezultat i mungesë së regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare.

E veçanta e këtyre zgjedhjeve është organizimi i tyre me sistem elektoral të ndryshëm nga zgjedhjet paraprake, ku tani Kryetari i Komunës zgjedhet drejtpërdrejt nga votat e popullit si dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës zgjedhën me sistem proporcional me lista të hapura.


Me ndryshimin e sistemit elektoral dhe të Rregullores Administrative të UNMIK-ut 2000/45 (që është zëvendësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30), është shfaqur nevoja për ndryshime administrative dhe të kornizës institucionale të Komunës. Si rrjedhim i kësaj është ndryshimi i numrit të drejtorive në komunë, si dhe eliminimi i pozicionit të Kryeshefit të Ekzekutivit. Roli i Kryetarit të Komunës është ndryshuar dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e tij janë rritur. Si rrjedhim, statuti i komunës është përshtatur sipas rregullores së re dhe është miratuar nga Kuvendi i Komunës. Është miratuar edhe organogrami i ri i Komunës, i cili i përshtatet realiteteve të reja organizative dhe politike. Struktura organizative e Komunës së Prishtinës është paraqitur në Figurën 1.

Rol kyç në qeverisjen demokratike ka shoqëria civile, e përfaqësuar nga organizatat joqeveritare. Ekzistojnë një numër shumë i madh (mbi një mijë) i organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe janë partnerë të rëndësishëm në zhvillimin social, demokratik dhe ekonomik të Komunës. Në fushën e sigurisë prezencë civile dhe ushtarake ndërkombëtare është kryesisht e koncentruar në territorin e komunës, ose i kanë të koncentruar qendrat (shtabet) kryesore. Kjo prezencë ka bërë të mundur realizimin e disa projekteve të përbashkëta.

Një shtyllë e rëndësishme në qeverisjen demokratike të Komunës së Prishtinës përbëjnë mediat kryesore të vendit cilat janë të vendosura në territorin e komunës, si ato publike edhe ato private të të gjitha profileve (radiofonike, vizuale dhe të shkruara). Prania e tyre në territorin e komunës nënkupton një qasje më kritike ndaj qeverisjes komunale dhe shpesh kërkim të llogaridhënies për veprimet/mosveprimet e institucioneve komunale.

Sfidë për kornizën institucionale dhe qeverisjen demokratike mbetet decentralizimi, i cili është i paraparë në pakon për statusin përfundimtar të Kosovës të propozuar nga ish-Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për negociatën për statusin përfundimtar të Kosovës, ish-Presidenti finlandez Maarti Ahtissari. Ky plan tani më është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe është përfshirë në Kushtetutën e vendit. Decentralizimi do të prekë pjesë të territorit të komunës dhe të kompetencave dhe përgjegjësisë të komunës. Si rezultat i definimit të statusit përfundimtar të vendit, është miratuar edhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale si dhe një paketë ligjesh që ndikojnë në qeverisjen lokale. Inkorporimi i tyre dhe zbatimi në praktikë mbetet një detyrë e rëndësishme e qeverisë komunale. Për shkak të rëndësisë si kryeqytet, Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashih hartimin e Ligjit për Prishtinën, i cili do të mundësojë riorganizimin administrativ territorial të Komunës së Prishtinës dhe do të sigurojë kompetenca shtesë dhe mundësi më të mëdha për zhvillim lokal të qëndrueshëm.

Figura 1. Skema organizative e Komunës së Prishtinës për vitin 2008



3. Buxheti: burimet e të hyrave dhe shfrytëzimi i tyre

Gjatë vitit 2007, Komuna e Prishtinës ka pasur të hyra prej rreth 30.2 milion € (tabela 1). Burimi kryesor i të hyrave të Komunës së Prishtinës është granti qeveritar që përbënë 62% të të hyrave të Komunës dhe pjesa tjetër vjen nga të hyrat vetanake. Nga të hyrat vetanake, pjesën më të madhe e përbëjnë të hyrat nga lëshimi i lejeve të ndërtimit (38% të të hyrave vetanake) dhe nga tatimi në pronë (24%).

Tabela 1: Të hyrat e përgjithshme të Komunës së Prishtinës për vitet 2007

Përshkrimi	Të hyrat në €	%
A. Të hyrat vetanake	11,509,833	38.09%
1 Administrata	158,518	1.38%
2 Të hyra nga Kadastrri	434,164	3.77%
3 Të hyra nga Inspekcioni	73,149	0.64%
4 Shfrytëzimi i sip. publike	363,869	3.16%
5 Transakcioni i pronës	685,199	5.95%
6 Licenca në biznes	382,338	3.32%
7 Të hyra nga trafiku	895,757	7.78%
8 Leje ndërtimi	4,448,590	38.65%
9 Tatimi në pronë	2,777,492	24.13%
10 Participime / Donacione	126,456	1.10%
11 Arsimi	778,174	6.76%
12 Shëndetësia	292,563	2.54%
13 Të hyra tjera	56,094	0.49%
14 Taksa rrugore	37,470	0.33%
A. Granti qeveritar	18,707,679	61.91%
1 Granti për Arsim	9,289,080	49.65%
2 Granti për Shëndetësi	3,210,191	17.16%
3 Granti për Administratë etj.	6,208,408	33.19%
TOTALI	30,217,512	100.00%

Tabela 2 në vijim paraqet të hyrat vetanake të realizuara për periudhën 2003-2007. Kjo tabelë jep informacione se ekziston një trend i rritjes së të hyrave vetanake, gjë që përputhet me rritjen e aktiviteteve ekonomike në Komunën e Prishtinës gjatë viteve të fundit. Rritje më të madhe gjatë kësaj periudhe kanë pasur sidomos në të hyrat nga lejet e ndërtimit, të cilat pritet të vazhdojnë këtë trend edhe në të ardhmen.

Tabela 2: Të hyrat vetanake të Komunës së Prishtinës për vitet 2003-2007

PËRSHKRIMI	2003		2004		2005		2006		2007	
	Realizuara	%	Realizuara	%	Realizuara	%	Realizuara	%	Realizuara	%
Te hyra nga trafiku	226,045	5%	602,071	14%	813,311	13%	1,081,093	11%	895,757	8%
Administrata	136,201	3%	116,621	3%	125,672	2%	124,090	1%	158,518	1%
Te hyra nga Kadastrri	172,087	4%	159,453	4%	190,456	3%	312,546	3%	434,164	4%
Te hyra nga Inspekcioni	207,064	5%	136,767	3%	91,808	1%	99,025	1%	73,149	1%
Qiratë	39,870	1%	9,320	0%	3,900	0%	40,774	0%	-	0%
Leje ndërtimi	405,115	10%	58,751	1%	303,536	5%	2,999,452	31%	4,448,590	39%
Transakcioi i pronës	417,100	10%	390,250	9%	513,030	8%	561,105	6%	685,199	6%
Shfrytëzimi i sip. publike	298,195	7%	177,219	4%	223,808	4%	382,424	4%	363,869	3%
Licenca në biznes	214,218	5%	407,158	9%	369,271	6%	434,970	4%	382,338	3%
Tatim në pronë	1,033,075	25%	1,536,281	35%	2,181,436	35%	2,454,482	25%	2,777,492	24%
Te hyra tjera	43,668	1%	43,835	1%	48,617	1%	54,653	1%	56,094	0%
Participime/ Donacione	170,881	4%	138,448	3%	171,580	3%	6,950	0%	126,456	1%
Arsimi	625,427	15%	426,300	10%	781,597	13%	775,626	8%	778,174	7%
Shëndetësia	210,854	5%	227,342	5%	416,936	7%	345,165	4%	292,563	3%
Taksa rrugore	-	0%	-	0%	-	0%	-	0%	37,470	0%
Totali	4,199,801	100%	4,429,818	100%	6,234,959	100%	9,672,356	100%	11,509,831	100%

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2007, ka shpenzuar 27.4 milion € (Tabela 3). Nga kjo shumë, 36% është shpenzuar për investime kapitale për të mbuluar nevojat e shumta për investime infrastrukturore, në arsim, shëndetësi etj., ndërsa pjesa tjetër është shpenzuar për paga, mallra dhe shërbime. Në kolonën e fundit të tabelës 3, tregohet se shpenzimet për arsim dhe shëndetësi marrin pjesë me rreth 55% në shpenzimeve totale të Komunës së Prishtinës. Ky është indikacion i popullsisë në rritje në Komunën e Prishtinës dhe i nevojës për të ofruar shërbime arsimore dhe shëndetësore për numrin gjithnjë në rritje të banorëve të Komunës së Prishtinës.

Tabela 3: Struktura e shpenzimeve të Komunës së Prishtinës për vitin 2007

Përshkrimi	Pagat	M&Sh	Komunali	Subvencione	Kapitale	Totali	%
1 Administrata komunale	1,453,573	1,582,296	434,690	125,954	7,730,639	11,327,153	41.31%
2 Shëndetësia	2,128,737	711,143	218,980	116,112	652,418	3,827,389	13.96%
3 Arsimi	8,044,450	1,583,394	676,282	-	1,237,851	11,541,976	42.10%
4 Zjarrfikësit	268,726	77,037	2,602	-	164,200	512,566	1.87%
5 Zyra lokale e komuniteteve	50,948	69,618	11,046	-	73,272	204,885	0.75%
6 Zyra për kthim të komuniteteve	2,874	-	-	-	-	2,874	0.01%
Gjithsej	11,949,308	4,023,487	1,343,600	242,066	9,858,380	27,416,842	100%
%	43.58%	14.68%	4.90%	0.88%	35.96%	100.00%	

4. Bizneset dhe rrethina e biznesit

Në Komunën e Prishtinës operojnë rreth 13,306 biznese (Tabela 4). Numri më i madh i këtyre bizneseve janë të orientuara në veprimtari tregtare. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, rreth 54% e bizneseve merren me tregti dhe hoteleri, 15% në transport, 8% në patundshmëri dhe vetëm 4% në veprimtari përpunuese. Kjo tregon për një shpërndarje jo shumë të volitshme sipas sektorëve të biznese në Komunën e Prishtinës. Megjithëse sektori i tregtisë dhe hotelierisë është sektor intensivë sa i përket punësimit (për të cilën gjë ka shumë nevojë në Prishtinë, për shkak të papunësisë dhe koncentrimit të madh të popullsisë). Është e nevojshme që bizneset të nxiten në veprimtari që janë të natyrës prodhuese dhe potencialisht eksportuese. Kjo do ta zvogëlonte deficitin e madh tregtar të Kosovës dhe do të kishte efekte tjera multiplikuese në vend.

Tabela 4: Shpërndarja e bizneseve sipas veprimtarisë në Komunën e Prishtinës

Përshkrimi	Numri i bizneseve	%
1. Bujqësi, gjueti, pylltaria dhe peshkim	142	1%
2. Industria nxjerrëse	370	3%
3. Industri përpunuese	551	4%
4. Prodhimi i pajisjeve elektrike, makinave etj.	120	1%
5. Furnizimi me energji elektrike, gaz, ujë, avull, ujë të ngrohtë dhe ndërtimtaria	696	5%
6. Tregtia me shumicë dhe pakicë, hotelet dhe restorantet.	7,156	54%
7. Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	2,007	15%
8. Afarizmi me pasuri të patundshme	1,074	8%
9. Arsimi, mbrojtja shëndetësore dhe sociale	427	3%
10. Veprimtari të tjera	763	6%
Totali	13,306	100%

Burimi: Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, 2007

Aktivitetet ekonomike shërbyese janë kryesisht të koncentruara në hapësirën urbane të qendrës dhe në zonat urbane të lagjeve: “Dardania”, “Ulpiana”, “Kodra e Diellit”, “Lakërishta”, “Qendra” dhe “Aktashi”. Në zonën e Qendrës dominojnë institucionet administrative të pushtetit qendror dhe lokal, hotelet, restorante, bankat, objektet kulturore, lokalet tregtare me pakicë dhe selitë e zyrave të bizneseve të ndryshme. Organizimit hapësinor i Qendrës ruan vlerat dhe standardet urbane të realizuara kryesisht në periudhën e paraluftës, ndërsa pas luftës kemi fenomenin e shndërrimit të hapësirave banesore në përdhës dhe të kateve të para të banesave kolektive, në lokale afariste për

qëllime komerciale. Në zonat tjera të urbanizuara në kuadër të veprimtarive terciare ushtrohet aktivitet i llojllojshëm i shërbimeve duke dominuar tregtia me pakicë dhe restorantet. Me plane rregulluese të miratuara për lagjet: “Qendra 1”, “Qendra 2”, “Dodona”, “Tophane”, “Kalabria”, “Mati”, “Sofalia” dhe “Lakërishta” (dhe “Dardania” që pritet të dalë në diskutim publik së shpejti), parashihet zgjerim i aktiviteteve të biznesit në zonat e ndërtuara apo në ndërtim e sipër.

Nyjat kryesore ekonomike në Komunën e Prishtinës shtrihen në aksin rrugor Prishtinë - Fushë Kosovë dhe Prishtinë - Ferizaj. Me hartimin e Planit dhe Strategjisë për Zhvillim Urban të Prishtinës (PSZHUP) për vitet 2004/2020+, janë definuar lokacionet për veprimtari ekonomike dhe jo-ekonomike, si: unazat e qytetit, autostrada Prishtinë-Merdar, nyjat strategjike për zhvillim të ekonomive shërbyese (Prishtinë-Aeroport), zona industriale ekzistuese prej 60 ha, zona industriale prej 600 ha si dhe Prishtina e Re me një sipërfaqe prej 1,000 ha. Këto hapësira të reja do të ofrojnë mundësi shtesë për zhvillimin e biznesit sipas standardeve më të mira.

Me PSZHUP janë të detajizuara sidomos dy zonat industriale. Zona ekzistuese industriale që shtrihet në aksin rrugorë Prishtinë – Fushë Kosovë, me një sipërfaqe neto prej 60 ha, momentalisht administrohet nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) dhe procesi i privatizimit është në vazhdim. Zona e dytë industriale është në veri-perëndim të Prishtinës me një sipërfaqe të dedikuar prej 600 ha. Kjo është momentalisht hapësirë e identifikuar, e pa ndërtuar dhe pa infrastrukturë përcjellëse. Edhe kjo zonë është në administrim të AKM-së.

5. Shërbimet publike

5.1. Organizimi i shërbimeve publike

Për të pasur pasqyrë të qartë të organizimit të shërbimeve publike në komunën e Prishtinës duhet të merren në konsideratë disa elemente, të cilat mund të kualifikohen si elemente të përbashkëta të shërbimit civil dhe shërbimeve publike në Kosovë. Në Kosovën e pasluftës është ndërtuar një administratë e paanshme politike dhe që reflekton karakterin shumetnik të Kosovës. Stafit është i punësuar mbi kritere të meritës nëpërmjet procedurave të hapura dhe korrekte konkurruese.

Pasuria e ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike (ujin dhe shërbimet e ujërave të zeza, grumbullimin e mbeturinave, drenazhin e ujërave sipërfaqësore, rrugët dhe shërbimet e pastrimit të rrugëve etj.) menaxhohet nga AKM-ja. Shumica e aseteve komunale që shfrytëzohen nga këto ndërmarrjeve në pronësi shoqërore (toka, patundshmëritë, materialet) janë marrë nën ombrellën e AKM-së (mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 “*Për krijimin e AKM-së*” dhe Rregullores 2005/18 që e plotëson të parën). AKM-ja tani është futur në procesin e inkorporimit të ndërmarrjeve publike me qëllim të përmirësimit të qeverisjes korporative, ngritjes së transparencës financiare dhe procedurave të llogaridhënies. Për të rritur transparencën dhe llogaridhënien para qytetarëve për aktivitetin e këtyre ndërmarrjeve është nxitur një debat për zgjerimin e përfaqësimit të autoriteteve komunale në bordet e ndërmarrjeve publike.² Rregulloret e tjera të UNMIK-ut dhe udhëzimet qeveritare u japin disa kompetenca të kufizuara komunave, siç është kontrolli dhe menaxhimi i pronës, kontrollimi i ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimet publike, regjistrimi i bizneseve, arsimit parësor dhe dytësor, kujdesi parësor shëndetësor, mirëqenia sociale dhe çështjet e kadastrave. Kështu që ekziston baza se komunat kanë kapacitete për të menaxhuar me ndërmarrjet publike.

Shërbimet publike në Komunën e Prishtinës, ashtu si edhe në komunat tjera, janë të rregulluara me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45. Struktura e ofrimit të shërbimeve publike është e organizuar në formën e tillë që mbulohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, e cila ka për detyrë realizimin dhe

² Raporti Shiriti i Kaltër Seria #1 Decentralizimi dhe Qeverisja Lokale në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë.

mbikëqyrjen e shërbimeve publike, avancimin e tyre përmes programimeve, planifikimeve e monitorimeve, ndërtimin e strategjisë për investime në lëmine e shërbimeve publike dhe harmonizimin e veprimtarive të subjekteve tjera, të cilat direkt apo indirekt merren me këto shërbime. Kjo drejtori bën mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, të rregulloreve dhe të akteve tjera nënligjore, mbikëqyrjen e pastrimit të qytetit dhe bartjen e mbeturinave, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, funksionimin e transportit publik urban të udhëtarëve dhe parkingjeve publike me pagesë. Shfrytëzimi i hapësirave publike është kompetencë e Komunës vetëm brenda territorit të qytetit d.m.th. brenda shenjave treguese të Prishtinës.

5.2. Investimet në infrastrukturë dhe në mirëmbajtje të rrugëve

Që nga përfundimi i luftës, Komuna e Prishtinës ka investuar mbi 12.6 milion € në infrastrukturën rrugore (Tabela 5). Të dhënat tregojnë se investimet më të mëdha në infrastrukturën rrugore janë realizuar më 2004, ndërsa pas këtij viti investimet kanë vazhduar të zvogëlohen (duke arritur shumën prej 1.6 milionë € në vitin 2006) për tu rritur prapë në vitin 2007.

Tabela 5: Investimet në infrastrukturën rrugore në komunën e Prishtinës gjatë viteve 2002-2007

Viti	Numri i projekteve	Gjatësia e rrugëve në km	Investimet në €
2002	7	7.2	91,550
2003	66	37.19	2,554,690
2004	52	27.35	5,101,976
2005	19	7.73	2,716,377
2006	19	9.02	1,674,365
2007	-	-	3,225,467
Gjithsej			12,648,048

Siç shihet në tabelën 6, gjatë periudhës së pasluftës janë bërë edhe investime në kanalizimin atmosferik, fekal dhe në sistemin e ujësjellësit.

Tabela 6: Investimet në sistemin e kanalizimit dhe të ujësjellësit

Periudha	Numri i projekteve	Kanalizimi fekal	Kanalizimi atmosferik	Sistemi i ujësjellësit
		m'	m'	m'
1999-2006	51	12,185	17,429	3,743

Në tabelën e mëposhtme (Tabela 7) shihen investimet dhe numri i përgjithshëm i rrugëve në mirëmbajtjen verore dhe dimërore gjatë viteve. Duke pasur parasysh buxhetin që ka Komuna e Prishtinës, shumat prej rreth 900 mijë € për mirëmbajtje të rrugëve është e konsiderueshme.

Tabela 7: Pastrimi dhe mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve

Viti	Mirëmbajtja verore (numri i rrugëve)	Vlera (€)	Mirëmbajtja dimërore (numri i rrugëve)	Vlera (€)	Total (€)
2004	42	226,931	83	100,497	327,428
2005	53	225,076	63	86,932	312,008
2006	31	147,626	119	110,960	258,586
Gjithsej:		599,634		298,389	898,023

5.3. Transporti, energjia dhe gjelbërimi

Transporti publik i udhëtarëve: Në komunën e Prishtinës janë funksionale 35 linja të rregullta, prej tyre 13 linja urbane dhe 22 linja ubane-periferike. Varësisht nga gjendja e rrugëve dhe frekuentimi i udhëtarëve, 19 linjat mbahen me autobusë dhe 16 me minibusë. Në këto linja janë të angazhuar 100 autobusë dhe 52 minibusë. Kompanitë të cilat kryejnë transportin publik të

udhëtarëve nuk gjenerojnë të hyra për buxhetin komunal, por kryejnë vetëm shërbime. Në tërë qytetin tani operojnë 20 ndërmarrje transportuese. Pas largimit të automjeteve 8+1 (kombi), shërbimet në transportin e udhëtarëve janë përmirësuar dukshëm dhe me këtë është rritur siguria dhe përgjegjësia ndaj udhëtarëve. Kjo gjithashtu ka ndikuar në mënjanimin e pengesave në trafik. Megjithatë, prapë hasen probleme të mëdha ngase: (i) ka mungesë të vend-pritjeve me mbulojë për udhëtarë, (ii) ka mungese të vendeve për ndalje të autobusëve, (iii) stacionet periferike nuk janë të rregulluara për kthim dhe nisje të autobusëve dhe (iv) dëmtimi i shenjave vertikale paraqet problem për pikat ku duhet të ndalen autobusët. Orientimet e Komunës së Prishtinës janë që të sigurohet transport publik integral që merr në konsiderim të gjitha format e transportit publik për të rritur efikasitetin dhe mënjeluar ngarkesën e vetëm një forme të transportit publik.

Sinjalizimi horizontal dhe vertikal: Në sinjalizimin vertikal dhe horizontal është punuar çdo vit, varësisht nga mjetet buxhetore. Për shkak të gjerësisë së pamjaftueshme në shumë rrugë, sinjalizimi nuk mund të kryhet sipas rregullave për komunikacion, ngase mungon trotuari ose objektet janë skaj rruge dhe nuk ka mundësi teknike për vendosjen e shenjës. Me shenja vertikale deri më tani janë pajisur 150 rrugë, varësisht nga gjendja e rrugës dhe kërkesa për rregullimin e trafikut rrugor. Rregullimi i përparësisë së kalimit është bërë në 34 udhëkryqe. Me sinjalizim horizontal janë shënuar 24 rrugë ku përfshihen: vendkalimet për këmbësorë, vijat e ndalimit (stop), vijat e ndërprera ndarëse, stacionet BUS, shigjetat orientuese të sinjalizimi vertikal etj. Problem të madh paraqet dëmtimi i shenjave dhe humbja e tyre. Investimet në sinjalizim, sipas viteve, kanë qenë si më poshtë:

- 2003 janë investuar 78,628 €,
- 2004 janë investuar 179,825 €,
- 2005 janë investuar 184,425 €,
- 2006 janë investuar 57,965 €.

Mirëmbajtja e semaforëve: Në Prishtinë janë të montuar 15 një semaforike, prej të cilave të aktivizuara janë gjithsejtë 14 që mirëmbahen rregullisht. Për mirëmbajtjen e semaforëve prej vitit 2003 deri 2006, nga buxheti i Komunës së Prishtinës janë shpenzuar mjete në shumë prej 309,939 €. Gjendja e semaforëve ekzistues është jo e mirë, për arsye se ato janë të ndërtuara para 30 vitesh dhe si të tilla kanë dalë jashtë përdorimit dhe ka mungesë të pjesëve rezervë.

Parkimi: Në krahasim me numrin e automjeteve, sipërfaqet për parkim të automjeteve janë shumë të vogla dhe nuk plotësohen nevojat e qytetarëve dhe të atyre që gravitojnë qytetin gjatë ditës për punë të ndryshme. Kjo paraqet problem të madh në qarkullimin normal të automjeteve dhe të këmbësorëve. Për ta lehtësuar sadopak çështjen e parkimit, në 13 rrugë është ndarë shiriti në rrugë për parkim dhe janë dhënë në shfrytëzim me koncesion me kohë maksimale të parkimit 1 orë. Nga kjo formë e organizimit me koncesion, buxheti komunal për vitin 2006 ka pasur të hyra në shumën prej 167,342 €.

Ndriçimi publik: Ndriçimi publik në Prishtinë aktualisht është në gjendje jo të kënaqshme. Në Prishtinë ekzistojnë 477 rrugë të kategorive të ndryshme me gjatësi rreth 180 km, 90% prej të cilave para lufte kanë pasur ndriçim publik. Gjatë periudhës 2003 – 2006, për riparimin e ndriçimit publik janë siguruar mjete nga buxheti i Komunës së Prishtinës në shumë prej 625,939 €. Me këto investime janë sanuar për ndriçim vetëm 189 rrugë, të cilat mirëmbahen rregullisht. Për shpenzimin e energjisë elektrike, gjatë mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe semaforëve në periudhën 2003–2006 janë shpenzuar rreth 726,648 €.

Objektet elektro-energjetike të KEK-ut të tensioneve të ndryshme që kanë rëndësi parësore në zhvillimin ekonomik të qytetit, nuk janë në nivel të duhur për arsye se janë të vjetruara dhe me fuqi të pamjaftueshme. Ndërtimin e trafostacioneve dhe largëpërçueseve të tensioneve të ndryshme në territorin e Komunës së Prishtinës e menaxhon KEK-u. Nga programi i zhvillimit afatgjatë të KEK-

ut duhet siguruar të dhënat e nevojshme për ndërtimin e objekteve elektro-energetike në periudhën deri në vitin 2011 vetëm për territorin e komunës së Prishtinës.

Telefonia dhe interneti: Objektet kryesore të karakterit telekomunikues janë: PTK-ja, IPKO, KUJTESA dhe të tjerë. Infrastruktura e objekteve të PTK-së është e pamjaftueshme për nevojat e qytetarëve, sidomos mbulimi me valë i territorit të Prishtinës. Infrastruktura e objekteve të IPKOS dhe KUJTESËS është në zhvillim e sipër.

Gjelbërimi: Për të pasur cilësi më të lartë të jetesës dhe për të krijuar ambient më të mirë jetësor, është e rëndësishme që qyteti të ketë hapësira gjelbëruese, të cilat janë në dispozicion të banorëve dhe të të gjithë njerëzve që frekuentojnë qytetin e Prishtinës. Sipas llogarive të bëra rezultojnë se në qytetin e Prishtinës janë gjithsej 453,587 m² sipërfaqe gjelbëruese. Me anë të projekteve të reja synohet që këto sipërfaqe të rriten në masë të dukshme dhe të merren nën mirëmbajtje të gjitha sipërfaqet që janë jashtë kësaj zone. Megjithatë ekipi punues ka një përgatitje superiore, nevojiten trajnime të domosdoshme në këtë sferë, pasi që ndotja dhe mbrojtja e mjedisit ka marrë dimension global. Nevojiten fushata për vetëdijësimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit si dhe koordinim më i mirë me inspektionin për ambient.

6. Zhvillimi dhe qëndrueshmëria urbane

Në nivel qendror institucioni përgjegjës për fushën e planifikimit urban dhe çështjeve mjedisore është Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (MMPH), gjegjësisht Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH). Ndërsa në nivel lokal përgjegjës është Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUKMM). Kjo drejtori mes tjerash është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik në nivel të komunës, duke qenë kompetente edhe për çdo aktivitet përcjellës në këtë drejtim.

Kjo drejtori përballlet me një numër vështirësish që pengojnë funksionimin më efikas si: (i) numri i vogël i stafit, (ii) mungesa e teknologjisë informative moderne (me programe profesionale, si GPS), (iii) mungesa e Institutit për Planifikim në kuadër të Drejtorisë; (iv) mungesa e Planit për Zhvillim të Komunës, (v) koordinim joefikas i aktiviteteve me drejtoritë tjera brenda komunës etj.. Kësaj duhet shtuar edhe mungesën e të dhënave zyrtare statistikore për këtë fushë tematike që zakonisht sigurohen nga Enti Statistikor i Kosovës. Mungesa e regjistrimit të popullsisë dhe pronës në Kosovë që nga viti 1981 e vështirëson tej mase prezantimin e gjendjes reale në këtë fushë.

6.1. Planet hapësinore të komunës

Bazuar në Ligjin për planifikim hapësinor në Kosovë, në nivel lokal, çdo komunë është e obliguar të ketë: Planin Zhvillimor të Komunës (PZHK), Planin Zhvillimor Urban (PZHU) dhe Planet Rregulluese Urbane. Në vitin 2004, Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Konzorciumin e instituteve gjermane, hartoi “Planin strategjik - zhvillimi urban i Prishtinës 2004-2020+” (PSZHUP).³ Plani në fjalë përcakton orientimet zhvillimore urbane të Komunës së Prishtinës. Komuna i konsideron ato të jenë udhëzues për zhvillimin e Prishtinës deri në vitin 2020+. Deri në kompletimin e të dhënave substanciale demografike, si dhe të dhënave të tjera relevante, ky plan mundëson dhe drejton hartimin e planeve joformale si pjesë integrale të Planit zhvillimor urban: planeve ideore, planeve të trafikut, planeve të qendrës së qytetit, planeve rregulluese urbane për zonat e banimit, zonat ekonomike, zonat tjera të qytetit, të cilat janë esenciale për zhvillimin e saj. PSZHUP nuk pretendon të jetë plani përfunduar. Si rrjedhim i njëjti do të pësojë ndryshime në zhvillimet e

³ PSZHUP është ekuivalent me PZHU.

mëtejme dhe do të përshtatet me kërkesat ligjore aktuale. Sa i përket planeve rregulluese urbane, deri në fund të vitit 2007 janë miratuar rreth 11 plane të tilla në kuadër të PSZHU-së së Prishtinës.

6.2. Çështje kyçe në planifikim hapësinor në komunën e Prishtinës

Toka dhe shfrytëzimi i tokës: Tregtia me tokën bujqësore në Kosovë nuk është e rregulluar me ndonjë akt formal juridik. Lartësia e këtij çmimi varet nga klasa e tokës, mundësia e ujitjes, qasja në infrastrukturë rrugore etj. Ligji në fuqi për tokë bujqësore trajton çështjet si: shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore. Eksproprijimi i tokës bëhet në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal (KK) duke e shpallur interesin publik për atë pronë. Kompensimi i m² të tokës ndërtimore të eksproprijuar caktohet si përqindje e çmimit mesatar në treg. Kompensimi mund të caktohet me të holla ose kompensim për tokë tjetër përkatëse bujqësore apo ndërtimore.

Sa i përket sistemit kadastral, në aspektin ligjor, kjo çështje është rregulluar me Ligjin nr. 2002/5 për Rregullimin e regjistrit të së drejtës së pronës së patundshme, si dhe Ligjin nr.2003/5 mbi Kadastrin. Sipas këtij ligji zyrat komunale të Kadastrit dhe kontrolluesit e licencuar, janë nën autoritetin e Agjencionit Kadastral të Kosovës, udhëzimeve administrative dhe akteve tjera nënligjore të lejuara nga Ministria e Shërbimeve Publike. Programi për përmirësim të administrimit të tokave në Kosovë (edhe në komunën e Prishtinës) përfshin këto komponentë: (i) ngritje institucionale, (ii) mirëmbajtje të Kadastrit dhe zhvillimit të regjistrit të pronësisë së pronës së patundshme, (iii) zhvillim të sistemit informativ të tokës, kadastrit, (iv) zhvillim të të dhënave gjeografike/ hapësinore dhe të infrastrukturës, (v) shkollim, zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe trajnim të kuadrove.

Banimi - Migrimi rural-urban: Prishtina si qytet/komunë ka të regjistruar shkallën më të lartë të migrimit intern (Raporti i UNDP/2004). Migrimi më i shprehur është në drejtim rural-urban, edhe pse është i pranishëm edhe ai urban-urban (nga qytetet tjera të vendit për në Prishtinë). Intensiteti më i lartë i këtij migrimi është shënuar në vitet e pasluftës së vitit 1999. Kjo gjendje tani është stabilizuar pak a shumë, por nuk është ndërprerë. Sa i përket zhvillimit njerëzor, Prishtina klasifikohet si komuna me indeksin më të lartë të zhvillimit njerëzor (IZHNJ) prej 0,72%. Kjo mund të jetë edhe reflektim i të ardhurave mesatare të larta në krahasim me komunat e tjera. Sa i përket banimit në zonën urbane të komunës, çmimi joformal i shit-blerjes së sipërfaqes së objektit për banim (në objekte kolektive të banimit), sillet prej 400-1,200 €/m², varësisht nga lokacioni, etazhi etj. Lartësia e çmimit bie në drejtim qendër-periferi e qytetit. Në zonat e qytetit për të cilat ka plane rregulluese, çmimi i tokës ndërtimore sillet prej 10,000-100,000 €. Ndërkaq, në zonat e pambuluara me plane rregulluese ky çmim sillet 5,000-10,000 €/ari. Sa i përket qiradhënies, një apartament mund të merret për shfrytëzim me qira mujore prej 150-1,000 €, varësisht nga lokacioni, madhësia, mobilimi dhe kushtet tjera që ofrohen. Për objekte të banimit individual/shtëpi dhe objekte afariste, kjo qiradhënie sillet prej 1,000-20,000 € e më shumë, varësisht nga lokacioni, madhësia, destinimi etj. Nuk ka indikator të caktuar që do të tregonte kërkesën dhe ofertën për objekte banimi sot në komunë. Një ngritje ekstreme e çmimit të objekteve për banim krahasuar me situatën para luftës së vitit 1999, ishte prezentë menjëherë pas vitit 1999. Tani, jo zyrtarisht vërehet një rënie e çmimeve për objektet e banimit me tendencë stabilizimi. Po ashtu, është konstatim jozyrtar se këto çmime të objekteve për banim/ afarizëm që janë në Prishtinë aktualisht janë më të lartat jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon.

Popullsia: Në mungesë të të dhënave zyrtare nga regjistrimi i popullsisë, pronës, objekteve të banimit dhe objekteve tjera, numri i saktë i popullsisë dhe i njërive të banimit nuk dihet. Të dhënat e prezantuara nga burime të ndryshme ndryshojnë dhe saktësia e tyre është për t'u diskutuar. Sipas PSZHUP numri i njërive të banimit për gjithë komunën është 68,000, përderisa vetëm për zonën urbane ky numër është 56,600. Ka supozime se ky numër mund të jetë edhe më i madh. Sipas të njëjtit burim, numri mesatar i anëtarëve të familjes në Prishtinë është 6.2, me madhësi mesatare të

banesës prej 67 m², si dhe sipërfaqe banimi për person prej 11 m². Për dendësinë e popullsisë në qytetin e Prishtinës, të dhëna të përpunuara ofron PPU/1988. Dendësia e banorëve sipas këtij plani nuk ishte e njëjtë në tërë hapësirën. Ajo mesatarisht për qytetin ishte 220 banorë/ha. Me PSZhUP parametri i dendësisë së banorëve për ha parashihet të ndryshojë dukshëm në favor të komoditetit dhe kjo mendohet të jetë 120-150 banorë/ha. Në rrethanat ekzistuese, mund të thuhet se pjesët e urbanizuara të qytetit (Qendra, Ulpiana, Lakërishta, Kodra e Diellit, Dardania etj.) janë më të populluarat krahasuar me periferinë. Këtë dendësi e ofrojnë njësitë e banimit kolektiv, që janë në numër më të madh në këto pjesë. Pjesët e qytetit të mbuluara me plane rregulluese i kanë të parapara edhe ndërtimet për banim kolektiv me qëllim të mbajtjes së një baraspeshe të këtij indikator.

Nuk ka studime të veçanta që do të tregonin për strukturën dhe shtrirjen e kategorive të veçanta sociale të popullsisë në Prishtinë. Mund të thuhet se një koncentrim i qytetarëve me gjendje më të mirë materiale është në pjesë të urbanizuara të qytetit. Kjo, për arsye të kushteve më të mira për banim dhe afarizëm. Nga ana tjetër, nuk ka dukuri të lidhjeve të lagjeve me ndonjë grup specifik etnik apo religjioz. Në të gjitha pjesët e qytetit/komunës, gjenden banorë të besimeve të ndryshme, të cilët jetojnë në një tolerancë të plotë religjioze.

Lagjet periferike të qytetit/komunës, po shënojnë zhvillim më të shpejt krahasuar me pjesët e urbanizuara. Kjo për arsye të mungesës së hapësirës në këto të fundit. Këto zhvillime janë më shumë të aspektit ekonomik dhe të banimit (horizontal dhe vertikal). Jo gjithmonë këto zhvillime përcillen njëkohësisht edhe me zhvillim fizik (të infrastrukturës përcjellëse) dhe sipas planeve rregulluese të komunës.

Hapësirat joformale:⁴ Për Komunën e Prishtinës historikisht asnjëherë nuk është bërë ndonjë studim detal lidhur me hapësirat joformale të saj. Prania e këtyre hapësirave është kryesisht e shprehur në qytetin e Prishtinës. Shikuar në tërësi, Prishtina deri në fazën e hartimit të planeve rregulluese kishte karakter të një qyteti me shumicë të hapësirave joformale. Përgjatë bënin lagjet urbane, si: Dardania, Kodra e Diellit, Ulpiana, Lakërishta dhe Qendra. Pjesa joformale karakterizohet me ndërtime pa leje, në prona me pronësi private të pazgjidhur, me ndërtime në prona shoqërore, me ndërtime pa infrastrukturë fizike-teknike sipas standardeve. Si të tilla janë lagjet: Kodra e Trimave, Dodona 1, Ramiz Sadiku dhe Kolovica e Vjetër. Për dallim nga këto, lagjet si Mati-1, Kalabria, Dodona, Tophane, Arbëria, Sofali dhe Lakërishta mbulohen me plane rregulluese.

Në mungesë të të dhënave nga regjistrimi zyrtar statistikor, fondi i tërësishëm banesor dhe numri i përgjithshëm i ndërtimeve joformale saktësisht nuk dihet. Përafërsisht llogaritet se ndërtimet ilegale marrin pjesë me mbi 50 % të fondit të tërësishëm banesor dhe mbi 60 % të territorit brenda kufirit të rajonit ndërtimor. Shkaqet dhe shkalla e degradimeve nga ndërtimet e këtilla të pasluftës janë studiuar dhe analizuar parcialisht. Duke parë zhvillimet e pasluftës së vitit 1999, MMPH hartoi "Draftligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje". Në ndërkohë miratoi Udhëzim Administrativ për trajtim të hapësirave joformale.

Në periudhën e pas vitit 1999 është shënuar një ekspansion ndërtimesh të ndryshme dhe atë kryesisht nga konstruksioni i fortë. Këto ndërtime janë bërë në të gjitha hapësirat, brenda dhe jashtë zonave të urbanizuara, në sipërfaqe të gjelbëruara, në tokë bujqësore, në hapësira të rekreacionit, në zona me destinim tjetër të interesit publik, buzë rrugëve urbane dhe magjistrale, pranë binarëve të hekurudhës, afër trafove, nën largpërçues të tensionit të lartë, në trotuare, jashtë kufijve të ngastrave kadastrorë, jashtë vijave rregulluese dhe atyre ndërtimore, jashtë gabaritit dhe me etazhitet të tejkaluar. Disa nga to janë bërë në prona publike dhe në prona të huaja private. Janë uzurpuar hapësirat e përbashkëta dhe nënkulmet e banesave kolektive. Mbindërtimet dhe ndërtimet jashtë

⁴ Hapësirat joformale i referohen zonave të qytetit / komunës që karakterizohen me zhvillim joformal urban.

standardeve paraqesin rrezik të përhershëm për qytetarët dhe banorët e këtyre objekteve.

Jeta publike, argëtimi dhe rekreacioni në raport me hapësirën: Në komunën/qytetin e Prishtinës ekzistojnë hapësira të cilat kanë potenciale për zhvillime të ndryshme të jetës publike, argëtimit dhe për ushtrimin e aktiviteteve rekreative. Pjesa e urbanizuar e komunës/qytetit me lagjet: Lakërishta, Dardania, Ulpiana, Qendra, Tophane, Arbëria, Kodra e Diellit, Aktashi, Velania, etj., ofrojnë më tepër mundësi për zhvillim të jetës kulturore, arsimore, religjioze dhe të aktiviteteve administrative të niveleve të ndryshme. Edhe argëtimi familjar dhe individual realizohet kryesisht në këto pjesë të qytetit. Vendet e frekuentuara për këtë qëllim janë restorantet, kafenetë, klubet, kinematë, teatrot, fushat sportive dhe pishina e qytetit. Në pjesën perëndimore dhe jugore të qytetit, gjenden potencialet për zhvillim të aktiviteteve ekonomike, përdërisa në juglindje të Prishtinës ka më tepër hapësira për rekreacion dhe banim atraktiv.

Me PSZHUP 2004/2020+ është paraparë Qarku i Rekreimit. Ky qark përbëhet prej: parkut peisazhor rural, parkut të liqenit, brezit të gjelbër brenda qytetit, si dhe avenyve dhe bulevardeve kryesore. Parku rajonal "Gërmia", me sipërfaqe afërsisht 1,168 ha paraqet një potencial tjetër të madh për zhvillim të rekreacionit. Ky shtrihet në lindje të komunës/qytetit. Për momentin shërben për rekreacion të qytetarëve, por nuk ofron standarde të larta të infrastrukturës përcjellëse. Me Planin strategjik parashihet edhe zhvillimi i zonave për aktivitete sportive, atyre të rekreimit pasiv dhe aktiv, zonave për edukim-arsimim në natyrë, për ekspedita, shtigje natyrore, liqene për peshkim, dhe pika te caktuara për restorante dhe kafene të ndryshme. Të dhëna zyrtare profesionale të veçanta për gjendjen ekzistuese në këtë lëmë nuk ka. Përdërisa në objektet ekzistuese kanë qasje të gjithë, pa dallim të statusit social, besimit, kombësisë, racës, gjinisë, etj. Trendët urbane të zhvillimit në qytet sa i përket hapësirës së gjelbër janë mjaft shqetësuese. Shqetësimi mund të argumentohet me faktin se sipas Planit të përgjithshëm urban të Prishtinës të vitit 1981, Prishtina, brenda kufijve të rajonit ndërtimor kishte mesatarisht 5.92 m² hapësirë të gjelbër për një banor. Në rrethana të sotme, nëse supozojmë se numri i banorëve në qytet është afër 450,000 dhe se sipërfaqja e gjelbëruar në qytet nuk është shtuar, por përkundrazi është uzurpuar vazhdimisht, del se ky tregues aktualisht është 1,90 m² dhe si i tillë mund të konsiderohet jashtë çdo standardi minimal urban.

Trendët e zhvillimit/zgjerimit të komunës: Qyteti i Prishtinës shumicën e lagjeve që e përbëjnë i ka të mbuluara me plane rregulluese. Tash për tash komuna/qyteti i Prishtinës, po shënon zgjerim të shpejtë në të gjitha drejtimet, por jo me intensitet të njëjtë. Jo gjithmonë këto zgjerime bëhen duke respektuar planet ekzistuese në fuqi. Në mënyrë të planifikuar, sipas PSZHU 2004/2020+, zgjerimi i komunës së Prishtinës mendohet të bëhet: (i) në drejtim të hapësirës jugore, përmes zonës Prishtina e Re, me një potencial përafërsisht prej 1 000 ha, si dhe (ii) në drejtim perëndimor të komunës drejt Zonës Industriale, me sipërfaqe prej 600 ha. Zgjerimet përfshijnë në masë më të madhe hapësirat për banim, por edhe ato për aktivitete ekonomike. Kërkesat e qytetarëve për ndërtim të objekteve banesore dhe afariste, janë duke ecur me dinamikë më të shpejtë nga kapaciteti i organeve të Komunës për të përballuar kërkesat e tilla.

7. Zhvillimi rural

7.1. Popullsia dhe infrastruktura në zonat rurale

Komuna e Prishtinës ka 48 fshatra, të organizuara në 16 bashkësi lokale. Sipas të dhënave që ka në dispozicion Komuna, në këto fshatra jetojnë rreth 7,000 familje. Në disa fshatra, sidomos ato që i takojnë Malësisë së Gollakut, vërehet lëvizje e madhe e popullatës (sidomos e të rinjve) në drejtim të zonave urbane. Kështu, disa fshatra të cilat kanë qenë shumë të populluara, tani kanë numër shumë të vogël të banorëve, si Nisheci, Radasheci, Kukaj, Hajkobilla, Gllgovica etj. Arsyet kryesore të

dukurisë së braktisjes së fshatrave janë mundësitë e pakta për punësim në fshatra dhe kushte më të mira jetese në zonat urbane. Mungesa e kapaciteteve përpunuese, infrastruktura jo e mire, mungesa e mjeteve investuese për ta zhvilluar një bujqësi moderne, ka shkaktuar po ashtu ndjenjë të pa perspektivës dhe atë sidomos në zonat e thella kodrinore-malore.

Fshatrat e Komunës së Prishtinës kanë trashëguar një infrastrukturë shumë të dobët. Gjatë viteve 2000-2003, investimet nga e donatorëve kanë qenë të konsiderueshme dhe pas kësaj periudhe investimet kryesore janë bërë nga komuna. Në periudhën 2003-2006, investimet e komunës në infrastrukturën e zonave rurale kanë qenë 4 milion €, ndërsa investimet nga donatorët 333,000 €.

7.2. Resurset në zonat rurale

Klima: Zonat rurale të Prishtinës dhe në përgjithësi komuna e Prishtinës, karakterizohen me ndryshime klimatike kontinentale, me ndonjë ndikim të klimës së mesme. Temperaturat mesatare vjetore, sipas të dhënave shumëvjeçare meteorologjike, sillen nga 9,2-11,6 °C. Temperaturat më të ultë mesatare hasen gjatë muajve dhjetor-janar dhe më të lartat hasen në muajt korrik-gusht. Reshjet më të mëdha vërehen gjatë muajve tetor, nëntor, dhjetor, ndërsa më të ulëta në korrik-gusht. Andaj, ky element duhet pasur parasysh në planifikimin e prodhimit intensiv bimorë, sidomos prodhimit të perimeve: patates, misrit dhe bimëve industriale.

Resurset ujore: Lumenjtë e komunës së Prishtinës kryesisht varen nga reshjet dhe shkrirja e borës. Sasia e rrjedhshme e tyre varet nga sasitë rrjedhëse të ujit dhe nga sipërfaqet e pellgjeve të tyre. Sasitë më të mëdha të ujit (rreth 70%) rrjedhin gjatë periudhës jashtë vegjetative (tetor-prill), ndërsa sasitë tjera (afër 30 %) rrjedhin gjatë periudhës vegjetative. Si rezultat, në muajt e verës, kur kërkesat e përgjithshme të bimëve për ujë shtohen, sidomos për ujitje, shumë përrenj dhe lumenjtë e vegjël thahen plotësisht, kurse në lumenjtë më të mëdhenj sasia e ujit bie në minimum. Kjo mungesë e ujit paraqitet si faktor kryesor kufizues i zhvillimit të gjithmbarshëm të prodhimit bujqësor në komunën e Prishtinës. Hulumtimet e kryera tregojnë se nga sasia e përgjithshme e sipërfaqeve punuese, vetëm 10% e sipërfaqeve punuese ujitën, ndërsa sasia tjetër e sipërfaqeve (90%) nuk ujitet. Një pjesë e tokës ujitet nga lumi i Llapit, me rënie të lirë, dhe në një pjesë tjetër ka mundësi të shfrytëzohet ujitja nga hidrosistemi i "Ibër-Lepenci".

Për nevoja të pijes, higjienës dhe kërkesave akute, banorët e Prishtinës me rrethinë përdorin ujin nga penda në Badovc me vëllim rreth 360 litra për sekondë, në Batllavë me vëllim prej rreth 570 litra për sekondë, në Gazivodë në shtratin e lumit Ibër, furnizim nga Komuna e Fushë Kosovës etj. Mirëpo, për nevojat afatgjate të prodhimit bujqësor për ujë në regjionin e Komunës së Prishtinës dhe për nevojat e konsumit të popullsisë, bujqësisë, industrisë, peshkatarisë etj., është e domosdoshme të sigurohen sasi tjera të ujit përmes akumulimeve të reja.

7.3. Aktivitetet ekonomike në zonat rurale

Prodhimtaria bujqësore: Shumica e familjeve në fshatrat e Kosovës, sidomos atyre që jetojnë në rajonet prodhuese, posedojnë sipërfaqe të tokës mjaft të vogël dhe në shumicën e rasteve të shpërndarë në disa parcela. Ky është një element mjaft kufizues për zbatimin e një teknologjie bashkëkohore në prodhimtarinë bujqësore në përgjithësi. Ndërtimi i shtëpive pa plan, pompave të benzinës, objekteve tjera përcjellëse (të cilat do të mund të ndërtoheshin në toka më pak cilësore), kanë bërë që fondi i tokës bujqësore të zvogëlohet në vazhdimësi. Gjithashtu, është mjaft shqetësues fakti se kjo tendencë është duke vazhduar edhe tani.

Madhësia e fermës është faktorë shumë i rëndësishëm në prodhimtarinë bujqësore. Rreth 50 % të fermave kanë sipërfaqe rreth 1 ha, ndërsa 80% të familjeve kanë ferma të madhësisë deri në 3 ha. Në

rajonet kodrinoro-malore madhësia e fermës është më e madhe, por në shumicën e rasteve, qoftë për shkak të mungesës së ujitjes, shpërnguljes së madhe të njerëzve, apo edhe arsyeve të tjera, këto sipërfaqe nuk janë të punuara, shfrytëzohen për kullosa, e ne raste më të rralla hasen edhe drithëra.

Aktualisht, në fshatrat e komunës së Prishtinës bujqësia është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë. Megjithatë, prodhimi bujqësor në këtë rajon është mjaft i ulët në raport me kushtet agroekologjike që posedon dhe potencialeve të mundshme prodhuese dhe produktivitetit përkatës që haset në vendet e zhvilluara. Faktorët që ndikojnë në realizimin e rendimenteve të ulëta janë të shumtë, nga të cilët, për këtë rajon, mund t'i veçojmë: niveli i ulët i teknologjisë së zbatuar në prodhimtari, përdorimi i farërave dhe inputeve tjera jociësore dhe mungesa e lagështisë gjatë periudhës së vegetacionit (sidomos për misër, jonxhë dhe bimë industriale). Në periudhën 2003-2006 qeveria lokale e Komunës së Prishtinës në bujqësi ka investuar 231000 € dhe 14,000 € janë investuar nga donatorët.⁵

Prodhimtaria e drithërave: Në rajonin e fshatrave të Prishtinës kjo prodhimtari është e ulët dhe nuk dallon shumë nga mesatarja e realizuar në nivel vendi. Të dhënat për rendimentet tregojnë se potencialet prodhuese të kultivarëve dhe hibrideve bashkëkohore të këtyre bimëve që arrijnë mbi 10 t/ha, duke u shfrytëzuar në shkallë shumë të ulët për vetëm 20-30%. Struktura e kultivarëve dhe hibrideve që përdoren për mbjelljen e drithërave në rajonin e komunës së Prishtinës, është mjaft heterogjene, porse shfrytëzimi i tyre nuk përkon me potencialet prodhuese që kanë. Nga këto sipërfaqe kultivuese është realizuar rendiment mesatar i ulët, i cili nuk dallon shumë nga mesatarja e përgjithshme vendore (3-3,5 t/ha, varësisht nga fshati). Në vitin 2003 sipërfaqet e kultivuara me drithëra kanë qenë 9,555 hektarë, në 2004 kanë qenë 10,840 hektarë, në 2005 kanë rënë në 9,200 hektarë dhe pastaj në 5,346 hektarë në vitin 2006.

Kultivimi i perimeve: Kjo veprimtari në fshatrat e komunës së Prishtinës është mjaft heterogjene. Në fshatrat e pjesës perëndimore dhe jugperëndimore (kryesisht ato që shtrihen përgjatë lumit Llap), kjo prodhimtari është më e avancuar dhe për të ekziston një traditë relativisht e mire. Në një të kaluar jo shumë të largët, këto fshatra madje kanë qenë furnizuesit më të rëndësishëm të Prishtinës me perime dhe patate. Në rajonet tjera prodhimi i perimeve bëhet kryesisht në parcela të vogla, kryesisht për nevoja të familjes, e shumë rrallë prodhohet për treg.

Kultivimi i pemëtarisë: Në fshatrat e Komunës së Prishtinës në shumicën e rasteve, banorët e këtyre fshatrave, kultivimin e pemëve e bëjnë në kopshte për rreth shtëpive, në sipërfaqe të vogla, kryesisht për nevoja të familjes. Prodhimi për treg është tepër i rrallë. Kultivimi i pemëve behet në mënyrë ekstensive. Kryesisht kultivohet molla, dardha dhe kumbulla me një sipërfaqe prej 57 ha.

Livadhet: Komuna e Prishtinës ka një sipërfaqe të livadheve prej 3,181 ha. Livadhet e kositen vetëm një herë dhe të njëjtat janë të ekspozuara në kushtet e prodhimtarisë aride (pa ujitje). Shfrytëzimi i tyre aktualisht është mjaft ekstensiv dhe nuk përkon me kërkesat e zhvillimit intensiv të bimëve foragjere dhe blegtorisë. Sa i përket kullosave (6,300 ha), shfrytëzimi i tyre është ekstensiv, me kullosa të lira dhe të paorganizuara nga bagëtia. Fshatrat kodrinore-malore kanë kushte të mira të merren me mbajtjen dhe kultivimin e suksesshëm të kategorive tjera të bagëtisë, si: dele, dhi dhe shpesë.

Blegtoria: Sa i përket fondit blegtoral, përkatësisht numrit të bagëtisë, ngjashëm me rajonet tjera, edhe fshatrat e Prishtinës patën humbje të mëdha të numrit të bagëtisë gjatë luftës. Numri i përgjithshëm i gjedheve në fshatrat e Prishtinës konsiderohet të jetë mbi 7,100 krerë, i deleve 1,500 krerë, 180 krerë dhi dhe 8,500 shpesë. Në ripërtëritjen e fondit të bagëtisë deri me tani ndihmuan

⁵ Burimi: Personeli i Komunes se Prishtines.

edhe disa OJQ. Në gjedhtari përbërja racore në shumë fshatra akoma vërehet se është ekstensive me një produktivitet të ulët. Mirëpo, në dy-tri vitet e fundit vërehet një përmirësim racor.

Pyjet: Rajoni i komunës së Prishtinës përkufizohet me pyje të cilat kanë hidrografi të theksuar, kryesisht janë gjethegjera dhe përfshijnë një sipërfaqe prej 28 284 ha. Karakteristikë e fshatrave të këtij rajoni janë malet e ulta dhe të mesme të cilat hasen në lindje. Për shkak të nevojave për dru djegës dhe lëndë ndërtimore, pyjet e rajonit të Prishtinës janë mjaft të shkatërruara dhe ky shkatërrim po vazhdon ende, duke degraduar kështu sipërfaqe të mëdha pyjore. Ndihet nevoja e pyllëzimit të sipërfaqeve të reja. Sipërfaqet me pyje paraqesin resurse natyrore dhe është obligim i të gjithë faktorëve të ndërlydhur, të angazhohen në përdorimin efikas e të qëndrueshëm të këtyre resurseve në të mirë të banorëve të rajonit të Prishtinës. Kjo nënkupton ndalimin e prerjeve të egra të pyjeve dhe ngritjen e vetëdijes së banorëve për rëndësinë e pyjeve dhe të industrisë pyjore.

Komuna e Prishtinës menaxhon me këto sipërfaqe: Parkun rajonal “Gërmia”, me hapësire prej 1,168 ha dhe pyjet e Badocit (Kerpat) liqenin me 527 ha, që gjithsej është 1 695 ha. Në vitin 1987 për shkak të bukurive të veçanta natyrore, vlerave burimore, estetiko-natyrore, me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, një pjesë e Gërmisë është shpall Park Rajonal Natyror, në sipërfaqe prej 1,168 ha. Sipas IUCN (Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës), ky park bën pjesë në kategorinë V të mbrojtjes si pejsazh i mbrojtur (Protecteo anoscape) dhe në vitin 1997 është i evidencuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura. Parku rajonal natyror “Gërmia” me vlerat e tij burimore-natyrore, turistike-rekreative është kategorizuar në tri zona mbrojtëse. **Zona e parë** përfshin pjesët me vlera të larta natyrore, të cilat meritojnë tretman të veçantë (shkallën I të mbrojtjes). **Zona e dytë** përbën pjesën më të madhe të parkut në të cilën zbatohet shkalla afatgjate e mbrojtjes. **Zona e tretë**, që është zona rekreative-turistike apo kontakt zona, përbën pjesën hyrëse të Gërmisë, ku ndryshimet burimore janë të lejuara. Parku “Gërmia” u nënshtrohet rreziqeve të natyrave të ndryshme, si: prerjet e organizuara dhe prerjet ilegale, uzurpimet dhe ndërtimet ilegale, qarkullimi enorm dhe i pakontrolluar i makinave të vizitorëve dhe hedhja e mbeturinave dhe zgjerimi i qytetit në drejtim të Gërmisë.

8. Arsimi, kultura, rinia dhe sporti

Në përputhje me legjislaturën në lëmin e arsimit, struktura e arsimit parauniversitar në komunën e Prishtinës është e organizuar në tri nivele: parashkollor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm të lartë. Prishtina ka gjithsej 69 institucione shkollore të arsimit fillor dhe të mesëm, në të cilat mësimin e vijnë 50,697 nxënës.

Në edukimin parashkollor janë të përfshirë 1,638 fëmijë të sistemuar në 9 shkolla dhe 51 paralele. Edukimi parashkollor në arsimin e përgjithshëm merr pjesë me 3.7%. Pjesëmarrja e minoritarëve në arsimin parashkollor është 10.2%. Me këta nxënës punojnë 3,342 mësime. Në arsimin e obliguar mësimin e vijnë 34,772 nxënës, me të cilët punojnë 1,597 arsimtarë të përgatitur relativisht mirë. Përfshirja e nxënësve në arsimin e obliguar shënon shkallën përmbi 90%. Mësimi zhvillohet në 41 shkolla. Ky nivel i arsimit përfshin 62% të lokaleve të dedikuara për mësim në komunën e Prishtinës. Arsimin e mesëm të lartë e vijnë 14,048 nxënës në 19 shkolla me të cilët punojnë 864 arsimtar.

Prishtina ka mungesë të madhe të hapësirës shkollore dhe mësimore, sidomos në shkollat e qytetit. Për këtë arsye shumica e shkollave fillore në qytet punojnë në tri ndërrime, kurse disa edhe në katër ndërrime. Standardet e hapësirës për zhvillim të mësimin për një nxënës janë nga 1,8 deri 2.2 m² ndërkaq aktualisht në shkollat e Prishtinës kjo mesatare është 0.86 m². Nga aspekti i pjesëmarrjes me hapësirë të shkollave dhe numër të nxënësve në nivel vendi, Komuna e Prishtinës përfaqësohet me

7.25% të hapësirave shkollore ndërkaq pjesëmarrja e nxënësve nga Komuna e Prishtinës në nivel vendi është 15.73%. Kjo situatë rezulton ngase në Komunën e Prishtinës nuk janë ndërtuar objekte shkollore gjatë viteve të 1990-ta. Po ashtu në këtë situatë kanë kontribuar edhe imigrimi i madh i popullsisë në Prishtinë gjatë periudhës së pas-luftës. Afër 20-25% të nxënësve, të cilët vijnë në mësimin në shkollat e komunës të Prishtinës në të gjitha nivelet janë nxënës të ardhur nga komunat tjera të Kosovës. Proporcioni nxënës/shkollë në komunën e Prishtinës për vitin 2006/2007 është 735 nxënës për një shkollë. Ndërkaq në vitin 2005/2006 ky proporcion ishte 692 nxënës për një shkollë. Kjo mesatare pasqyron fluksin e nxënësve në kryeqytet, që është një rritje prej 6% të numrit të nxënësve për një shkollë brenda dy viteve shkollore.

Afër 2,600 ose 77% e mësimit dhe personelit menaxherial kanë ndjekur ndonjë formë të trajnimit. Ndër organizatat që kanë dhënë kontribut të veçantë në trajnimet mësimit, të drejtorëve dhe të zyrtarëve arsimorë dhe që i kanë mbështetur edhe materialisht trajnimet janë: KEDP, GTZ, FSDEK (grupi Finlandez) pastaj KEC, Kosvet, Agjencioni kanadez CIDA e tjera.

Në Komunën e Prishtinës mësimi zhvillohet në katër gjuhë: shqipe, serbe, boshnjake dhe turke. Komuna e Prishtinës ka 3,212 nxënës të minoritetit serb dhe 436 nxënës të minoriteteve turq, boshnjak dhe ashkalinjë. Shumica e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve e vijnë në mësimin në gjuhën e shqipe, ndërkaq një pjesë në gjuhën serbe dhe boshnjake. Arsimi për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillohet në tri shkolla me 12 paralele në të cilat janë të përfshirë 115 nxënës.

Për fushën e arsimit ndahen vetëm rreth 4.1% e Bruto Prodhimit Vendor (BPV). Ky buxhet nuk siguron investime kapitale të mjaftueshme, të ardhura për mësimit, pajisshmëri me mjete mësimore në shkolla etj. Pozita materiale e mësimit nuk është motivuese, kështu që kemi dukurinë e largimit të arsimtarëve dhe ekspertëve nga sektori i arsimit që është duke u reflektuar në cilësinë e arsimit.

Në Prishtinë janë të regjistruara 60 klube publike sportive dhe 4 klube private. Prej tyre 10 klube janë të femrave dhe 53 klube të meshkujve. Duke marrë parasysh numrin e banorëve, Prishtina ka mungesë të terreneve sportive dhe të hapësirave rekreative. Funkcionimi i klubeve publike është i bazuar në buxhetin komunal i cili është i pamjaftueshëm për zhvillimin e këtyre klubeve. Nuk ka një infrastrukturë ligjore stimuluese për biznese të cilat dëshirojnë ta mbështesin sportin.

Sektori i kulturës ballafaqohet me vështirësi të mëdha për shkak të mungesës mjeteve materiale, njerëzore dhe në infrastrukturë-objekte ku do të zhvillohej veprimtaria kulturore. Buxheti i aktual nuk mjafton që të realizohen projekte kulturore të rëndësishme për qytetin. Prishtina ka 2 teatro publike, Bibliotekën Universitare dhe Bibliotekën e Qytetit "Hivzi Sylejmani" me 13 degët e veta, Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Muzeun e Prishtinës, Arkivin e Prishtinës, Shtëpitë e Kulturës (Hajvali, Graçanicë, etj), Qendra kulturore e fëmijëve, Radiot dhe Televizionet publike dhe private në Prishtinë, Filharmonia-Opera e Kosovës, Baletin e Kosovës, Festivalin e Teatrit Ndërkombëtar në Prishtinë, Shoqëritë, grupet amatore të zhanreve të ndryshme muzikore në Prishtinë, Festivalin e muzikës serioze artistike në Prishtinë, Festivalin e fëmijëve, dhe Festivalin e Filmave të ndryshëm artistik privat në Prishtinë etj. Prishtina po zhvillohet në qendër diplomatike të rëndësishme (me zyre dhe institucione të rëndësishme ndërkombëtare). Frekuentimi i vizitorëve potencial është në rritje të vazhdueshme. Së këndejmi, kujdesi i institucioneve në prezantimin e vlerave kulturore të qytetit duhet të jetë dukshëm më i fokusuar.

9. Shëndeti publik dhe mirëqenia sociale

Në Prishtinë janë të vendosura institucionet kryesore shëndetësore, siç janë Klinikat Universitare (QKU), Instituti Kombëtarë të Shëndetit Publik etj. që ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët e Kosovës, ndërkaq komuna ka të zhvilluar rrjetin e qendrave të mjekësisë familjare.

Në përgjithësi, mbrojtja shëndetësore ofrohet përmes: Mbrojtjes Primare (Mjekësia Familjare), Mbrojtjes Sekondare (Spitali) dhe Mbrojtja Terciare (Klinikat). Sipas rregulloreve mbi vetëqeverisjen e komunave, vetëm kujdesi primar shëndetësor menaxhohet nga komuna të cilat detyrime i realizon përmes mjekësisë familjare. Ndërsa mbrojtja sekondare dhe ajo terciare menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë. Sa i përket sektorit për mirëqenie sociale, kompetencat po ashtu qëndrojnë në nivelin të Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Mbrojtja primare shëndetësore: Komuna e Prishtinës ofron mbrojtjen primare shëndetësore përmes mjekësisë familjare: (i) shërbimet specialistike (pediatria, internisti, gjinekologjia, oftalmologjia, ORL, neuropsikiatria, dermatologjia, pneumoftiziologu, epidemiologu radiologu dhe specialisti i higjienës), (ii) shërbimet stomatologjike (sëmundjet e dhëmbit dhe gojës, kirurgjia orale, pedodont, protetika) dhe (iii) Enti i Urgjencës. Këto shërbime mjekësia familjare i realizon në: Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF 1), 9 Qendrave të Mjekësisë Familjare, 14 Punteve shëndetësore, 1 Poliklinikë stomatologjike, 7 Ordinancave stomatologjike dhe 6 Ambulancave Stomatologjike nëpër shkolla, Dispanseri antituberkular dhe Enti i Ndihmës së Shpejtë.

Tërë veprimtarinë shëndetësore sektori shëndetësor, përkatësisht mbrojtja primare shëndetësore e kryen në një hapësirë prej 19,425 m² me pajisje mjekësore moderne dhe mjete adekuate të transportit. Hapësira në dispozicion i plotëson standardet nëse shikohet si numër në total. Mirëpo, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë se për çdo 10 mijë banorë duhet të ekzistoj një Qendër e Mjekësisë Familjare, ekziston një disproporcion i shfrytëzimit të kësaj hapësire. Kjo rrjedh si pasojë e migrimëve të pakontrolluara të popullatës nga shumë fshatra në qytet dhe njëkohësisht si pasojë e mungesës së të dhënave mbi regjistrimin e popullsisë. Andaj, përdorimi i të dhënave të vitit 1981 mbi regjistrimin e popullsisë ka sjellë si rezultat ndërtimin e qendrave të mjekësisë familjare edhe në ato fshatra të komunës, të cilat realisht janë të braktisura nga banorët e tyre. Në anën tjetër, hapësira në Qendrën e Mjekësisë Familjare në disa lagje të Prishtinës dhe në fshatin Hajvali, nuk është e mjaftueshme për shkak të rritjes së numrit të popullsisë. Vlen të përmendet fakti se “QMF 1” në Prishtinë, si objekt nuk i plotëson standardet për zhvillim të veprimtarisë shëndetësore, e cila nuk ka as mundësi renovimi dhe për këtë arsye është nevojë urgjente ndërtimi i një objekti të ri. Përveç kësaj, rritja e numrit të banorëve në kryeqytet paraqet nevojë emergjente për ndërtimin e qendrave të reja të mjekësisë familjare.

Mbrojtja dytësore shëndetësore: Në mungesë të Spitalit të përgjithshëm, banorët e Prishtinës trajtohen kryesisht nga klinikat e specializuara. Nga kjo del se shërbimet sekondare dhe terciare në komunë funksionojnë si të përbashkëta. Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK-ja) shërbimet e veta i ofron përmes klinikave dhe instituteve të Fakultetit të Mjekësisë: Instituti i Patologjisë, Instituti i Fiziologjisë, Instituti i Patofiziologjisë, Instituti i Farmakologjisë, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Instituti i Anatomisë, Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publikë, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe Qendra Klinike Stomatologjike e Kosovës.

Personeli shëndetësor: Në nivelin parësor shëndetësor janë të punësuar gjithsej 777 punëtorë, prej të cilëve 642 janë punëtorë shëndetësorë, ndërsa 135 të tjerë janë punëtorë jo-shëndetësorë. Në grupin e personelit jo-shëndetësor hyjnë: punëtorët administrativë (33), punëtorët teknikë dhe rojet

(38) dhe punëtorët ndihmës (64). Tabela 8 pasqyron strukturën profesionale të personelit shëndetësorë në nivelin parësor.

Tabela 8: Struktura e personelit shëndetësorë në nivelin parësor

Profili i mjekëve	Nr.	Profili i mjekëve	Nr.
Mjekë familjarë	73	Specialistë higjiene	1
Mjekë në specializim	19	Stomatologë	30
Specialistë të praktikës	30	Specialistë protetike	7
Specialistë të mjekësisë së punës	2	Specialistë pedodont	5
Pediatër	24	Specialistë për sëmundjet e dhëmbit / gojës	3
Oftamologë	2	Kirurg oral	1
Internistë	4	Teknikë të dhëmbëve	12
ORL	2	Asistentë të dhëmbëve	41
Neuropsikiatër	2	Sociolog	1
Reumatologë	1	Teknikë të rëntgenit	6
Dermatologë	7	Infermiere/infermierë	281
Gjinekologë	8	Infermierë me shkollë të lartë	3
Radiologë	1	Infermiere – akushere	18
Pneumofiziologë	4	Ro-teknikë	7
Biokimistë	5	Laborantë	41
Epidemiolog	1		
Gjithsej			642

Mjekësia parësore ofron shërbimet e saj për banorët e Komunës së Prishtinës edhe përmes Entit të Urgjencës. Numri i përgjithshëm i personelit të këtij niveli shëndetësor është 85, prej të cilëve 55 janë punëtorë shëndetësorë, ndërsa 30 prej tyre janë punëtorë jo-shëndetësorë.

Për të plotësuar kriteret e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, se për 2 500 banorë duhet të ekzistojë një mjek i praktikës së përgjithshme, përkatësisht një mjek familjar, atëherë për t'u ofruar shërbime 450 mijë banorëve sa konsiderohet se ekzistojnë në komunën e Prishtinës, duhet të jenë të punësuar 180 mjekë të tillë. Të dhënat ekzistuese tregojnë se tash për tash Komuna e Prishtinës ka vetëm 122 mjekë të mjekësisë së përgjithshme, gjegjësisht mjekë familjarë. Komunës së Prishtinës i duhet të punësojë edhe rreth 60 mjekë të tillë. Kriteret e tilla janë përcaktuar edhe sa i përket shëndetit oral në mjekësinë familjare, në bazë të të cilave për 6 000 banorë duhet të jetë një mjek stomatolog. Nisur nga i njëjti numër i popullsisë, atëherë në komunën e Prishtinës për të ofruar shërbime adekuate në këtë nivel shëndetësor, duhet të jenë të punësuar 78 mjekë stomatologë. Të dhënat nga tabela e mësipërme tregojnë se edhe ky numër duhet të rritet për 48. Sipas ligjit, personeli tjetër i të punësuarve në këtë sektorë veprimtarinë e vet e kryejnë si mjek konsultativ.

Sa i përket punësimit të kuadrit të mesëm (motra/teknikë medicinale/infermierë), sipas kriterëve për 1 mjekë të praktikës së përgjithshme-familjar duhet të jenë të punësuar 2 motra, ndërsa për specialistë të tjerë ky raport duhet të jetë 1:1. Në bazë të të dhënave të paraqitura më lart, ky numër tash për tash është 302, ndërsa duhet të jetë 447 për të plotësuar kriteret shëndetësore. Për shëndetin mental kujdeset Njësia konsultative në QKMF, ku shërbimet shëndetësore në këtë lëmë i ofrojnë mjekët neuropsikiatër (2).

Mirëqenia sociale: Shumicën e rasteve sociale në nivel të komunës i trajton Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale përmes Qendrës për Punë Sociale, i cili institucion është kompetencë e kësaj ministrie. Vlerësohet se rreth 1,500 familje janë raste sociale nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit. Ato kryesisht jetojnë nëpër bodrume dhe shtëpi/banesa të uzurpuara.

10. Vlerësimi i aftësive konkurruese të Komunës së Prishtinës (SWOT analiza)

Në tabelën në vijim janë paraqitur në mënyrë të përmblëdhur përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e Komunës së Prishtinës për të siguruar një ambient të përshtatshëm jetese dhe biznesi dhe zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë të Prishtinës si kryeqytet i Republikës së Kosovës. Identifikimi i tyre është bërë bazuar në kornizën SWOT (në anglisht: S-strengths, W-weaknesses, O-opportunities, T-threats).

Tabela 9: Përmblëdhje e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës

FAKTORËT	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
